



Datë: 18.06.2025
Numër Protokoli: 4243/2025

A.nr.882/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.882/2025, të datës 14.05.2025, të parashtruar nga ankuesja J.R kundër organit të punësimit/Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.06.2025, me shumicë vota, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.882/2025, e datës 14.05.2025, e parashtruar nga ankuesja J.R.

A r s y e t i m

Ankuesja J.R (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 14.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos zbatimin e Vendimit me Nr./ 08/226 të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për klasifikimin e vendeve të punës ku pozita Zyrtar i Gjendjes Civile nga profesionale 3 është kategorizuar në profesional 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë Komuna e Kamenicës ,ndërsa kjo e fundit më datë 30.05.2025 ka përcjellë përgjigje në ankesë.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesit, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokoli 461/43 të datës 15.09.2011, është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare e gjendjes Civile në Komunën e Kamenicës. Tutje e njëjta fillimisht 24.03.2025, ka parashtruar një kërkesë për shqyrtim tek Shefi i Personeli në Komunën e Kamenicës për kategorizim nga klasa profesional 3 në klasën profesional 2.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se lidhur me mos zbatimin e Vendimit me Nr./ 08/226 të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për klasifikimin e vendeve të punës ku pozita Zyrtar i Gjendjes Civile nga profesionale 3 është kategorizuar në profesional 2.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë nenin 2 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 4 paragrafi 3 ku parashihet se: ” **Neni 2:** 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”, **Neni 14:** 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik...” referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Marr parasysh akt emërimin e ankueses Kolegji i Këshillit, konstaton se procedimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë e që sipas listës së pagave ankuesja rezulton se paguhet sipas koeficientit 3.9.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Komuna e Kamenicës nuk ka përfunduar ende procesin e klasifikimit të e vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e aplikueshme nga data 28.02.2024, rrjedhimisht me nenin 34 të kësaj rregullore përcaktohet se: ***Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje,*** dhe po ashtu, edhe me Vendimin me Nr.08/226, të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, më pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar se: ***Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë Klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog,*** ndërsa, më pikën 3 është shfuqizuar pika 3 dhe 4, të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16 shkurt 2023 të Qeverisë së Kosovës, pika këto që i referoheshin detyrimit të Ministrisë së Financave/Thesarit të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme/Departamentit për menaxhimin e zyrtareve publik për ekuivalentim të koeficienteve dhe korrigjimeve.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh që Komuna e Kamenicës, sipas Vendimit SH02 Nr. 2819 të datës 05.02.2025 ka formuar grupin për vlerësimin, klasifikimin e vendeve të punës dhe hartimin e Rregullores për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, vlerëson se pa pasur fillimisht klasifikimin e vendeve të punës, vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesja, për kategorizimin e pozitës së saj është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore, e si e tillë e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.882/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses J.R;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.